



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:106880

Datë: 14.02.2025

Numri i dokumentit: 06852430

C.nr.1713/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil gjyqtari Shyqri Hoxha, me praktikanten gjyqësore D.O. në çështje juridike kontestimore të iniciuar me padinë e paditësit D.K. nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Eurosig", me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit prej 1.000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 14 shkurt 2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET kërkesëpadia paditësit D.K. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të "**OBLIGOHET** e paditura Kompania e Sigurimeve "Eurosig", me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material në automjet për të gjitha kategoritë e dëmit paditësit të ia kompensoi shumën prej 1.000.00 euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e marrjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare e nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm më përmbarim, që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe të obligohet e paditura në pagimin e shpenzimeve të procedurës" **NË TËRESI SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi D.K. përmes të autorizuarit të tij Av. D.M. pranë kësaj gjykate me datë 26.05.2022, ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve " Eurosig" me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi.

I autorizuari i paditësit Av. D.M. me parashtrësën e datës 10.02.2025 , e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese me të paditurën kanë arritur

marrëveshje jashtëgjyqësore andaj, në mungesë të interesit juridik ka paraqitur tërheqjen e kërkesëpadisë, duke i kërkuar nga gjykata që të bie aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, pasi që paditësi nuk ka kërkesa tjera lidhur me këtë çështje kontestimore.

Gjykata ne kuptim te dispozitave nga neni 149 te Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1713/22, me datë 14 shkurt 2025

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.